



[www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)

Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj

# Pasqyra e çrregullimit të informacionit në Kosovë

Qershor 2024



# Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	4
Metodologjia.....	5
Përmbledhje .....	6
Të gjeturat kryesore.....	7
Zhvillimet në veri të Kosovës.....	9
Dialogu Kosovë-Serbi .....	14
Ndasitë politike .....	18
Gjuha e urrejtjes dhe mizogjene online .....	24
Ndikimi i huaj jodemokratik.....	27

Ky raport është mundësuar me mbështetjen e Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID në Kosovë. Opinione të shprehura këtu janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e NDI-së dhe USAID-it ose ndonjë individi të organizatave të lartpërmendura.

Copyright © Democracy for Development - D4D 2024. Të gjitha të drejtat e rezervuara.



# Hyrje

Ambienti mediatik sidomos në rrjetet sociale ka ndryshuar duke u dhënë mundësi portaleve të operojnë jo vetëm në faqet e tyre në internet por edhe në rrjetet sociale të cilat sot përdoren edhe si burim i informacionit. Të dalluarit në mes të informatës së saktë dhe çrregullimit të informacionit kanë rëndësi në shoqërinë demokratike dhe në ruajtjen e stabilitetit të një vendi. Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) që nga muaji korrik 2023 ka kryer monitorimin e mediave online dhe rrjeteve sociale në gjuhën shqipe dhe serbe, në kategori të caktuara të cilat përfshijnë: Zhvillimet në komunat me shumice serbe në Kosovë, dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Ndikimin ndërkombëtar, Gjuhën e urrejtjes dhe Mizogjeninë. Qëllimi i projektit është që të kuptohen dhe të luftohen të gjitha format e dezinformimit si lajmet e pavërteta, raportimet e njëanshme, clickbait, titujt senzacional (të bujshëm), manipulimet me informata, dhe teoritë konspirative.

Gjatë gjithë periudhës së monitorimit, D4D identifikoi dhe dokumentoi çrregullime të informacionit në të gjitha kategoritë tematike të monitoruara. Nga ndryshimet delikate në retorikën politike të përhapja e gjuhës së urrejtjes dhe fushatave të dezinformimit, gjetjet e kësaj nisme hedhin dritë mbi dinamikën e shumë-anshme që formëson sferën online. Monitorimi përfshinë edhe analizën e lajmeve ku ofrohet një shpjegim mbi shembujt e dhënë për të thjeshtëzuar të kuptuarit e formave të dezinformimit. Monitorimi dhe analiza e lajmeve është kryer në dy gjuhë, shqipe dhe serbe në lidhje me kategoritë e përmendura më lartë. Gjatë muajve të ndryshëm vërehen disa forma të çrregullimit të informacionit, si tituj të bujshëm, gjuhë e urrejtjes dhe nxitëse ndaj grupeve të marginalizuara, lajme të paverifikuara dhe teori konspirative.

# Metodologjia

D4D ka bërë monitorimin e mediave online dhe atyre në rrjetet sociale për të identifikuar lajmet/artikujt të cilat përmbajnë çrregullime të informacionit, përmes një platforme monitoruese digjitale, duke klasifikuar artikujt në bazë të kategorive: zhvillimet në veri; dialogu Kosovë-Serbi; gjuha e urrejtjes; dhuna online ndaj grave; ndasitë politike dhe ndikimi i huaj jodemokratik ndërkombëtar. Mediat online të cilat janë monitoruar përmes platformës kanë qenë mbi 100 media online vendore, të rajonit dhe ndërkombëtare, të përzgjedhura në një platformë monitoruese. Monitorimi dhe analizimi i artikujve me çrregullim të informacionit është bërë paralelisht në dy mostra: në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Përzgjedhja e shembujve nga të dyja mostrat është bërë duke u bazuar në përmbajtjen e artikullit i cili ka shpërndarë: dezinformata, manipulim të fakteve, përmbajtje të paverifikuara, lajm të pavërtetë, teori konspirative, clickbait, gjuhë të urrejtjes, gjuhë ofenduese, gjuhë kërcënuese, nxitëse, artikuj me tituj tendencioz, dhe raportim të njëanshëm.

Monitorimi përfshinë periudhën korrik 2023 - maj 2024, që është kryer përmes platformës monitoruese digjitale Pikasa, si dhe në mënyrë manuale janë monitoruar rreth 17,250 artikuj, prej të cilave 4,217 kanë rezultuar me çrregullim të informacionit, apo shprehur në përqindje rreth 20%. Sa i përket ndërveprimeve nga artikujt e analizuar në rrjete sociale kanë rezultuar mbi 4 milion (4.343.653), ndërsa mbi 14 milion (14.118.874) visitor në faqet online.

# Përmbledhje

Monitorimet mujore nga korriku i vitit 2023 deri më sot kanë rezultuar me forma të ndryshme të çrregullimit të informacionit. Nga lajme të paverifikara, informata të manipuluar, tituj konspirativ e të bujshëm, e deri te përmbajtja e gjeneruar nga inteligjenca artificiale, kanë mbizotëruar në ambientin mediatic në Kosovë.

Artikuj me përmbajtje të çrregullimeve të informacionit që nxisin tensione politike dhe konflikt ndër-etnik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ishin prezentë përgjatë muajit korrik. Pas marrjes së detyrës në objekte komunale të katër kryetarëve të komunave në veri të Kosovës, shumë politikanë, gazetarë dhe opinionistë nga Kosova dhe Serbia kanë qenë të përfshirë në shpërndarjen e narrativave nacionaliste dhe përçarëse që nxisin urrejtje ndëretnike. Shumë portale online dhe llogari në rrjete sociale, në gjuhën serbe dhe shqipe, gjatë zgjedhjeve në katër komunat në veri të Kosovës kanë shpërndarë informacione të paverifikuara gjatë situatës së tensionuar në komunat me shumicë serbe, duke kontribuar kështu në ndasi më të thella ndëretnike, shtimit të gjuhës së urrejtjes, dhe pasiguri tek qytetarët.

Në mostrën në gjuhën shqipe kanë dominuar artikuj dhe raportime në lidhje me sulmin në Banjskë, ku mediat televizive në përgjithësi kanë treguar kujdes gjatë raportimeve dhe publikimeve të informatave, ndërsa mediat online kanë publikuar informacione të paverifikara dhe kanë shpërndarë dezinformata. Mediat online kryesisht kanë shpërndarë fotografi dhe video të marra nga vende dhe ngjarje të mëparshme, që janë përdorur si materiale në lidhje ngjarjen e 24 shtatorit në Banjskë. Nga portalet online janë publikuar imazhe të ushtarëve nga Ukraina dhe Azerbajxhani. Po ashtu nga portalet online, janë vërejtur narrativa konspirative, në lidhje me tensionet në Banjskë dhe ngjarjeve që mund të ndodhin pas tensioneve të shtatorit. Aludimet konspirative në shumicën e rasteve kanë përmbajtje nega-

tive të cilat mund të përhapin pasiguri te lexuesit, dhe bazohen në mendime subjektive të cilat citohen dhe përdoren në titull dhe në përmbajtje.

Narrativa më e përhapur gjatë monitorimit njëvjeçar në mostrën në gjuhën serbe ka qenë “regjimi” dhe “spastrimi etnik” i Kurtit ndaj serbëve në veri të Kosovës. Supozimet në fjalë, krijojnë përshtypjen e gabuar të situatës në Kosovë, dhe krijohet një realitet tjetër për qytetarët në Serbi apo për lexuesit e mediave serbe.

Politikanët e Kosovës, veçanërisht gratë në politikë, kanë qenë shënjestër e dhunës online dhe komenteve misogjene përmes “meme” dhe artikuj që përmbanin gjuhë nxitëse. Gratë në politikë ishin veçanërisht në shënjestër për “deepfake”<sup>1</sup>, dezinformata dhe gjuhë mizogjene. Gjithashtu, gratë politike janë kërcënuar edhe me dhunë fizike për pikëpamjet e tyre politike gjatë transmetimit të drejtpërdrejtë.

Keqinterpretim i informacionit, siç ishte fjalimi i Presidentit të Francës, Emanuel Macron është edhe një ndër lajmet më të shikuara të muajit tetor. Për shkak të një gabimi në përkthim, mediat në Kosovë dhe Shqipëri raportuan se liberalizimi i vizave për Kosovën u “pezullua”.

Samiti në Spanjë, po ashtu ishte temë kryesore në mediat serbe, ku të ftuar ishin liderë nga vendet e Evropës, përfshirë këtu edhe nga Kosova dhe Serbia. Pas deklaratës së Presidentes Osmani se nuk do të takohej me Presidentin Vuçiq nëse BE-ja nuk vendos sanksione për sulmin e 24 shtatorit në Banjskë. Këtë deklaratë mediat në Serbi e konsideruan si hipokrizi nga ana e Presidentes Osmani, duke thënë se ajo ka udhëtuar në Spanjë me pasaportë serbe pa probleme dhe pa kushte. Një informatë e tillë keqinformon lexuesit serb për situatën politike në Kosovë.

# Të gjeturat kryesore

Kulmi më i lartë i postimeve ndodhi më 24 shtator 2023, i nxitur nga sulmi në Banjskë. Në atë ditë, mediat në Kosovë publikuan 3,360 artikuj lajmesh, të cilat mblohdën 161,807 ndërveprime. Në analizën e gjuhës së urrejtjes në Kosovë bazuar në fjalët kyçe të ofruara, kulmi më i lartë i artikujve të lajmeve përkoi me periudhën e sulmit në Banjskë, kryesisht për shkak të fjalës “Terrorist” të përdorur në mediat kosovare. Mirëpo, në totalin e përmendjeve ra fjala “vjedhje” me **8,313 përmendje**, e ndjekur nga “terroristë” me **5,830 përmendje**, “shpifje” me 3.048 përmendje, “provokon” me **1,426 përmendje**, dhe “homoseksual” me **1,110 përmendje**.

Dita e dhunës në Kuvendin e Kosovës, gjatë së cilës u sulmua kryeministri Kurti, shënoi ditën më aktive për mediat kosovare. Në këtë ditë u prodhuan **3,826 artikuj lajmesh** mbi këtë temë, duke gjeneruar **125,055 angazhime**. Të gjeturat kryesore nga monitorimi janë paraqitur në bazë të kategorive:

- > **Mizogjenia dhe nxitja e gjuhës së urrejtjes ndaj grave në Kosovë** - gjatë monitorimit të lajmeve në mostrën në gjuhën shqipe janë vërejtur tituj me gjuhë fyese dhe nxitëse ndaj grave në politikë duke përdorur tituj të ekzagjeruar që përmbajnë terma ofendues. Raportimet e njëanshme dhe me gjuhë ofenduese nxisin qytetarët që të përforcojnë gjuhën e urrejtjes ndaj grave në politikë dhe kufizon përfshirjen e grave në vendimmarrje.
- > **Polarizimi politik/gjuhë ofenduese** - përmes titujve të ekzagjeruar dhe me gjuhë fyese ndaj figurave politike në Kosovë është synuar polarizimi politik. Narrativat me gjuhë të urrejtjes në komunikimin politik rrënjosin edhe më thellë ndasitë e përkahësve në rrjetet sociale duke nxitur gjuhë të urrejtjes në mes të ndjekësve të mediave në rrjete sociale, duke kontribuar në polarizim më të thellë politik.

> **Mungesa e burimeve dhe informacioneve të besueshme** - artikujt nuk japin burime të besueshme ose informacione thelbësore që mbështesin titujt e tyre të bujshëm, duke çuar në dezinformata. Fenomeni i titujve të bujshëm që nuk përputhen me përmbajtjen e artikujve ose nuk japin informacion faktik është një tendencë shqetësuese në mediat online. Kjo praktikë e mediave online përdoret përmes krijimit të titujve për të tërhequr vëmendjen e lexuesit pavarësisht nga saktësia ose rëndësia e përmbajtjes. Problemi me titujt e bujshëm është mos përputhshmëria me përmbajtjen e artikujve. Zakonisht përfshihen deklaratat apo pohime të guximshme pa ofruar argumente apo fakte të mjaftueshme dhe të besueshme. Artikujt në fjalë kanë ndikim serioz në situata të ndjeshme dhe serioze, si në rastin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Dezinformimi përmes titujve të bujshëm sjellin ndasi dhe polarizim brenda shoqërisë. Për më tepër vëmendja e informacionit nga çështje të rëndësishme dhe komplekse bartet te artikujt me tituj të bujshëm që përbëjnë dezinformim.

> **Elementet spekulative** - titujt që përdorin gjuhë me elemente spekulative në lidhje me konflikte të mundshme në Kosovë që nxisin gjuhë agresive ndëretnike duke rritur rrezikun e përshkallëzimit të konfliktit, dhe duke nënvlerësuar përpjekjet diplomatike të Kosovës dhe Serbisë për të promovuar paqen dhe stabilitetin. Spekulumet ndodhin kur bëhen pohime ose nxjerrin përfundime bazuar në informacione jo të plota ose burime të paverifikuara. Në një shkallë, spekulimi është i natyreshëm në parashikimin ose analizimin e ngjarjeve të ardhshme, mirëpo spekulimet e pabaza mund të paraqesin sfida për besueshmërinë e medias dhe saktësinë e informacionit të paraqitur në publik. Problemi kryesor në lidhje me spekulimin është potenciali për keqinformim të lexuesve.

1 Korshunov, P., & Marcel, S. (2018). Deepfakes: a new threat to face recognition? assessment and detection. arXiv:1812.08685.

- > **Përdorimi selektiv i fakteve dhe citimeve** - narativat e pa verifikuar krijojnë duke përdorur faktet në mënyrë selektive dhe citate, të cilat shpesh nxirren jashtë kontekstit për t'iu përshtatur lajmeve të përgatitura, duke shtrembëruar kështu perceptimin publik. Në mostrën në gjuhën serbe janë vërejtur raste ku janë përdorur statistika të mbledhura nga Iniciativa Evropiane për Stabilitet (IES), një artikull të shkruar mbi besueshmërinë ndaj fakteve dhe statistikave që japin figurat politike serbe, të cilat përmenden në raport. Nga i gjithë raporti i IES-së, mediat serbe në mënyrë selektive citojnë vetëm pjesët që përputhen me lajmet e përgatitura jashtë kontekstit të raportit të publikuar nga IES.
- > **Propagandë dhe informata të paverifikuara** - në mostrën në gjuhën serbe vazhdojnë narativat e pavërteta kundër figurave politike në Kosovë, të cilat shpërndahen nga persona zyrtarë të sferës politike në Serbi si dhe nga mediat. Sa i përket marrëdhënieve Kosovë-Serbi, mediat serbe paraqesin Kryeministrin Albin Kurtin si shaktarin kryesor që nxit tensionet në mes të dy shteteve.
- > **Artikuj të paverifikuar në lidhje me spastrimin etnik të komunitetit serb në Kosovë** - përhapja e vazhdueshme e narrativave të pa verifikuara, siç është spastrimi etnik i serbëve në Kosovë dhe kërcënimet nga qeveria e Kosovës ndaj komunitetit serb nxit frikën dhe përçarjen dhe duke u shërbyer qëllimeve politike dhe jo të vërtetës.
- > **Titujt sensacional** - titujt përdorin gjuhë sensacionale për të kapur vëmendjen e lexuesve dhe përmes temave të ndjeshme siç është siguria, për ndikuar te emocionet në publik. Fjalët si “lojëra kufitare” dhe “zile në mesnatë zgjon Joe Biden”, synojnë të zgjojnë interesin e lexuesve ose të shkaktojnë shqetësim. Megjithatë, pa burime të konfirmuara për të mbështetur këto pretendime, ato janë dezinformuese dhe përbëjnë çrregullim të informacionit.
- > **Gjuha përçarëse** - titujt në gjuhën serbe në lidhje me Kosovën inkurajojnë gjuhë përçarëse, një nga shembujt është hedhja e dyshimeve mbi rolin dhe autoritetin e BE-së, tituj që pengon përpjekjet për normalizim të raporteve në mes të dy shteteve. Për më tepër, ajo nxit dyshime dhe pakënaqësi kundër BE-së në mesin e lexuesve kosovar dhe serb.

# Zhvillimet në veri të Kosovës

Artikujt e përzgjedhur më poshtë nëpërmjet metodologjisë së përdorur në këtë raport, tregojnë për çrregullim të informacionit gjatë raportimit për ngjarjet në veri të Kosovës, me fokus gjatë dhe pas sulmit terrorist që ndodhi në fshatin Banjskë nga një grup i armatosur serbë kundër policisë së Kosovës. Raporti ka konstatuar shpërndarje të madhe të informacione të çrregullta gjatë asaj periudhe, duke përdorur teori konspirative, përdorim të imazheve nga konflikte tjera të armatosura nëpër botë, manipulim të imazheve dhe audio-incizimeve, si dhe shpërndarje të informatave të pavërteta duke paraqitur një situatë panike dhe pasigurie, apo te shperthimit te nje konflikti te armatosure ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që mund të përfshijë të gjithë Ballkanin perëndimor. Mediat në gjuhën serbe kanë pasur tendencë që sulmin terrorist ta paraqesin si kryengritje të popullsisë lokale serbe kundër “regjimit shtypës” të Kryeministrin të Kosovës Albin Kurti, i cili sipas tyre ka plane për spastrim etnik të serbëve në veri të Kosovës dhe se këtë po e bënë në koordinim me ndërkombëtarët. Në anën tjetër, Presidentin e Serbisë mediat atje e kanë portretizuar sikur “shpëtimtar” që po mbron popullin serb në Kosovë.


Portali i lajmeve, Klan Kosova ka publikuar një artikull me titull: “S’ka më polici në veri pa KFOR-in e EULEX-in (VIDEO)”. Ky artikull ka përmbajtje të pavërtetë në titull. Sipas titullit të artikullit, thuhet që nuk do të ketë prezencë të policisë në veri të Kosovës. Ndërkaq, brenda artikullit gjendet komunikata zyrtare e Qeverisë së Kosovës, ku më saktësisht flitet për zvogëlim të prezencës së Policisë së Kosovës, dhe jo mos-prezencë të saj në veri. Kjo deklaratë është bazuar në komunikatën e Qeverisë së Kosovës pas një takimi në mes të Zëvendëskryeministrin të Kosovës, Besnik Bislimi dhe përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian, Miroslav Lajčak, që është mbajtur me 10 korrik. Portali i lajmeve nuk e ka interpretuar me saktësi komunikatën e Qeverisë së Kosovës, ku thuhet se “Policia e Kosovës bashkë me EULEX-in dhe KFOR-in, sipas nevojës do të vlerësojnë gjendjen e sigurisë, në veçanti për të shikuar mundësinë për zvogëlim të mëtejshëm të prezencës policore në dhe rreth ndërtesave komunale”.



Zëvendëskryeministrja e Kosovës, Emilija Rexhepi ka postuar një fotografi që paraqet ndërtesën e Komunës së Sarajevës, e cila është e ndriçuar me flamurin e Kosovës. Pas verifikimit nga D4D është vërtetuar se kjo nuk është e vërtetë dhe se fotografia është e montuar. Kjo fotografi është bërë virale në të gjitha rrjetet sociale, duke u shpërndarë nga përdoruesit të këtyre rrjeteve. Fotografia në fjalë, e shpërndarë nga Zëvendëskryeministrja e Kosovës, Rexhepi, hyn në kategorinë e keq-informimit ku përmbajtjet e fotografive shpërndahen pa u verifikuar paraprakisht.



Gazeta Aktuale ka postuar disa fotografi në rrjetin social Facebook, ku në to shihen trupa të ushtarëve të vranë me mbishkrimin në fotografi si: “Terroristi serb i shtrirë në tokën dardane” dhe një tjetër me përshkrimin: “Foto ekskluzive: edhe një terrorist serb i vranë në veri, gjenden dy trupat e tyre”. Pas verifikimit të D4D, fotot ku shihen dy trupa të vranë, nuk janë imazhe nga sulmi në Banjskë por njëri ilustrim është nga lufta ndërmjet Rusisë dhe Ukrainës, dhe imazhi tjetër është i një ushtari të vranë në Nagorno-Karabakh. Fotografitë e shpërndara janë imazhe të marra nga një kontekst tjetër të cilat në kohë tensionesh kur përdoren janë më të besueshme dhe marrin vëmendje.



Artikulli i postuar nga portali Kosovo Online tregon një audio-incizim nga radio e policisë së Kosovës, ku përkthehet “...edhe nëse vdes nuk ka asgjë”. Pas verifikimit, përkthimi i audio-incizimit është i shtrembëruar, audio është e shkurtër dhe nuk dëgjohet as edhe një fjali e plotë të jetë thënë nga polici kosovar. Fjalja është shtuar nga mediumi dhe shpërndarë edhe nga Presidenti i Serbisë. Ky postim përmban çrregullim të informacionit pasi që po shpërndan një informatë të pa verifikuar dhe të pavërtetë me qëllim të nxis ndasi ndër etnike.



Portali i partisë politike “SNS” ka publikuar artikullin me titull: “Vuçiq: Serbia e gatshme të ruaj/mbrojë jetën e popullit tonë”, duke iu referuar ngjarjeve në veri të Kosovës, dhe tentimeve për përshkallëzim të situatës. Lajme të tilla gjatë gjithë periudhës së muajit korrik kanë mbizotëruar ambientin mediatik në Serbi. Duke ju referuar ngjarjeve në katër komunat në veri të Kosovës, mbi protestat dhe prezencën e Policisë së Kosovës pranë komunave, është tentuar të përhapet frikë në mesin e qytetarëve se një luftë do të ndodh atje. Deklaratat e Vuçiqit për këto ngjarje kanë nxitur pasiguri dhe frikë. Vuçiq ka komentuar mbi situatën e tensionuar në komunat me shumicë serbe duke lënë hapësirë për të nënkuptuar se Serbia mund të sulmojë Kosovën për të mbrojtur popullin serb.



Portali Politika ka publikuar një artikull me titull: “Perëndimi mbështet apartheidin e Kurtit dhe persekutimin e serbëve”, ku më tej tregon opinionin e zëvendëskryetarit të Partisë Radikale Serbe, Aleksandar Sheshel, duke shtuar se: “Vendi ynë duhet të kundërshtojë në të gjitha mënyrat separatistët shqiptarë dhe të udhëheqë një politikë të mbrojtjes së popullit tonë”. Ky lajm përmban informacion të pavërtetë pasi që Albin Kurti nuk ka ndërmarrë ndonjë iniciativë që jep indikacione të qëllimeve për bashkim me Shqipërinë apo për separatizëm në mes të komuniteteve etnike brenda Kosovës, përderisa nuk ka ndonjë veprim aktual të Qeverisë së Kosovës që do ta vërtetonte këtë supozim.

**Zapad podržava Kurtijev aparthejd i progona Srba**

Naša zemlja mora da se suprotstavi albanskim secesionistima na sve načine i da vodi politiku zaštite našeg naroda


**Ky artikull ka grumbulluar gjithsej 356 ndërveprime, kur prej tyre janë:**

- Pëlqime: **305**
- Komente: **9**
- Shpërndarje: **42**

Mediumi serb Naslovina ka publikuar një artikull: “Vuçiq për CNN: Nuk kemi nevojë për konflikt me NATO-n, na intereson vetëm siguria e serbëve – Kurti dëshiron të vazhdojë spastrimin etnik”. Artikulli jep informata për intervistën e Presidentit të Serbisë Vuçiq për televizionin CNN, ku presidenti Vuçiq ka vazhduar narrativën se Kryeministri Kurti po bën “spastrim etnik” ndaj serbëve në veri të Kosovës, dhe fajëson shtete perëndimore se po mbajnë anën e Kurtit. “Ata bënë spastrim gradual etnik, që nga ardhja e Kurtit në pushtet ka 10 për qind më pak serbë në Kosovë dhe Metohi, ka pasur më shumë se 420 sulme ndaj popullit tonë në veri të Kosovës dhe Metohisë”- tha Vuçiq për CNN. Presidenti Vuçiq vazhdon me fajësimin dhe akuzat ndaj Kryeministrit Kurti nëpër mediat serbe dhe ndërkombëtare. Në anën tjetër, mediat serbe vazhdojnë të shpërndajnë të njëjtat narrativa sikurse Presidenti Vuçiq, duke nxitur ndasitë ndër-etnike dhe duke portretizuar shqiptarët si agresorë ndaj komuniteteve pakicë, veçanërisht ndaj komunitetit serb në Kosovë. Këto lajme cilësohen si jo të vërteta dhe të një-anshme, me përmbajtje të pa bazuara në fakte.

**Ky lajm ka grumbulluar 353 ndërveprime, ku prej tyre:**

- Pëlqime: **38**
- Komente: **133**
- Shpërndarje: **182**



**Vëllimi i artikujve të publikuar në media në ditë:**

Kulmi më i lartë i postimeve ndodhi më 24 shtator 2023, i nxitur nga sulmi në Banjskë. Në atë ditë, mediat në Kosovë publikuan **3,360** artikuj lajmesh, të cilat mblodhën **161,807** ndërveprime.

**STATISTIKA TË PËRGJITHSHME:**

Artikuj në media	<b>241,014</b>
Ndërveprime ne Facebook	<b>4,541,728</b>
Ndërveprime për artikuj	<b>19</b>
Numri i mediave	<b>114</b>
Postime në mediat sociale	<b>13,926</b>
Ndërveprime	<b>2,047,611</b>
Ndërveprime për postim	<b>147</b>

# Dialogu Kosovë-Serbi

Artikulli i përzgjedhur më poshtë nëpërmjet metodologjisë së përdorur në këtë raport, synon të tregojë për ngjarjet rreth dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për normalizim të marrëdhënieve që lehtësohet nga BE-ja. Gjatë raportimit për këtë proces ka pasur çrregullim të informacionit, që bazohet në shpërndarjen e informatave të pavërteta. Përgjatë raportimit për dialog, mediat kanë shpërndarë narrativa të pavërteta se gjoja Kosova dhe Serbia janë në prag të një lufte, gjë që mund të ndikojë negativisht në besimin e qytetarëve të dy shteteve në proces të dialogut.

Portali nga Serbia Novosti, ka publikuar një artikull me këtë titull: “Ajo kërkon sanksione për Serbinë, dhe hyri me pasaportë serbe në Spanjë: Presidentja false tregoi edhe një herë sa hipokrite është”. Ky artikull shkruan se si Presidentja e Kosovës kërkon sanksione ndaj Serbisë, para se të ketë bisedime me Presidentin Serb Vuçiq, në Grenada të Spanjës, ku të dy liderët ishin të ftuar. Më pas vijon duke cilësuar këtë deklaratë të Presidentes Osmani si hipokrizi dhe duke thënë se ajo vet ka udhëtuar me pasaportë serbe, duke u bazuar në faktin se Spanja nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, gjë që do të nënkuptonte edhe mosnjohjen e pasaportës së Kosovës. Mirëpo këshilltarja e Presidentes Osmani, ka deklaruar se Presidentja Osmani ka udhëtuar me pasaportë të re Republikës së Kosovës, me vizë të lëshuar nga Ambasada e Spanjës në Shkup. Në vijim, ky artikull shkruan se edhe figura të tjera politike në Kosovë si Albin Kurti, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli gjithashtu posedojnë pasaporta të Serbisë. Artikulli përmban çrregullim të informacionit për shpërndarje të një informate të pavërteta. Ky lajm cilësohet jo i vërtetë dhe keqinformon qytetarët serb se udhëheqës politik të Kosovës duhet të kenë pasaporta të Serbisë për të udhëtuar në vende që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

**TRAŽI SANKCIJE ZA SRBIJU, A U ŠPANIJU UŠLA SA SRPSKIM PASOŠEM: Lažna predsednica još jednom pokazala koliko je icemerna**

2 news articles

5 Pëlqime 11 Komete 148 Shpërndarje

Titujt janë mjete efektive për ndryshimin e perceptimit publik dhe të kuptuarit të ngjarjeve. Në dy titujt në vijim: “Lojërat me kufi, vendoset shkëmbim tokash me Serbinë” dhe “Lëvizje në kufirin me Serbinë/ Zilja në mesnatë zgjon Joe Biden”, duket se kanë një përpjekje të qëllimshme për të nxitur ndjenjën e urgjencës dhe panikut për lëvizjet kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Të dy titujt tregojnë se ka një aktivitet të rëndësishëm apo vendimmarrje për kufirin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, një analizë më e thellë zbulon se titujt janë mashtrues dhe përbëjnë dezinformata. Asnjë nga dy titujt nuk përfshin informacion të veçantë në lidhje me lëvizjet ose vendimet e supozuara të kufirit. Mungesa e saktësisë në raportim e bën të vështirë për lexuesit të identifikojnë ngjarjet ose vendimet që diskutohen. Të dy titujt përdorin gjuhë sensacionale për të tërhequr vëmendjen dhe për të nxitur pasiguri. Fjalët si “lojëra kufitare” dhe “zilja në mesnatë zgjon Joe Biden” synojnë të zgjojnë interesin e lexuesve ose të shkaktojnë shqetësim. Megjithatë, pa burime të konfirmuara për të mbështetur këto pretendime, ato janë dezinformuese, dhe si të tilla përbejnë çrregullim të informacionit. Pavarësisht nga gjuha dramatike e përdorur në titujt e lajmeve, historitë nuk përmbajnë asnjë provë apo vërtetim për pohimet e deklaruara. Në vend të kësaj, ata mbështeten në aludime dhe supozime të paqarta, duke përhapur në mënyrë efektive spekulime në vend që të përcjellin fakte aktuale. Duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të marrëdhënieve Kosovë-Serbi, përhapja e informacionit të pavërtetë për çështjet kufitare mund të ketë efekte negative. Ekziston potenciali për përshkallëzim të tensioneve, nxitje të pakënaqësisë dhe minim të përpjekjeve për paqe dhe siguri në rajon.

**LAJMI:**

17 Pëlqime 0 Komete 16 Shpërndarje

**YOUTUBE:**

1 artikull në media 2 video në Youtube

30 Pëlqime 1 Komete 7,498 shikime

Titulli “NATO ndez avionët e luftës, Shea jep lajmin e madh”, nuk është i qartë në lexim të parë duke përcjell një ndjenjë urgjence dhe frike që lë të kuptohet se aeroplanët e NATO-s po përgatiten për një bombardim të mundshëm. Megjithatë, përbrenda artikullit zbulon se nuk ka asnjë kërcënim të afërt për luftë. Në të vërtetë, artikulli thekson fjalët e Jimmy Sheas kur kujton bombardimet e vitit 1999 rreth misionit të NATO-s, diçka që ka përfunduar 25 vite më parë dhe që nuk ka lidhje me aktivitetin ushtarak aktual të NATO-s në Kosovë. Titulli përbën çrregullim të informacionit sepse shtyn lexuesit të besojnë se një luftë do të fillojë, ndërkohë që, në fakt, materiali ka karakter historik dhe nuk ka lidhje me ngjarjet aktuale, kjo formë e të shkruarit ndikon emocionalisht te lexuesit për të tërhequr klikime.

**LAJMI:**


- Pëlqime: 1
- Komente: 0
- Shpërndarje: 0

**YOUTUBE:**

- Pëlqime: 9
- Komente: 2
- shikime: 1,302

1 artikull në media  
1 video në Youtube

**Vëllimi i artikujve të publikuar në media në ditë:**



Kulmi më i lartë i postimeve ka ndodhur më 14 shtator 2023, gjatë takimit Kurti-Vuçiq në Bruksel. Në këtë ditë, mediat në Kosovë publikuan **1,756 lajme**, të cilat mblodhën **36,643 ndërveprime**.

STATISTIKA TË PËRGJITHSHME:	
Artikuj në media	148,213
Ndërveprime ne Facebook	2,500,756
Ndërveprime për artikuj	17
Numri i mediave	109
Postime në mediat sociale	4,878
Ndërveprime	573,759
Ndërveprime për postim	118

# Ndasitë politike

Artikujt e përzgjedhur më poshtë nëpërmjet metodologjisë së përdorur në këtë raport, synojnë të tregojnë për ngjarjet që kanë krijuar më së shumti ndasi politike por që për bazë kanë pasur çrregullim të informacionit. Mënyrat të cilat janë përdorur përfshijnë “deepfake”, ku përfshihen lider politik dhe përfaqësues të korit diplomatik në Kosovë, lajme të pavërteta që pretendojnë se Kosova po humbë mbështetjen nga NATO për shkak të politikave të Kryeministrit Kurti, si dhe debati për projektligjin për IVF që ka shkaktuar polemika të shumta.

Projektligji për Shëndet Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar ka ngjallur debate dhe polemika të konsiderueshme brenda vendit. Përkrahësit e këtij projektligji argumentojnë se legjislacioni përfaqëson një hap përpara në të drejtat riprodhuese dhe përparimet mjekësore, ndërsa kundërshtarët shprehin shqetësime në lidhje me implikimet e mundshme shoqërore, duke përfshirë rrezikun e incestit, paqartësitë në lidhje me kombësinë e donatorëve dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes që synon gratë që kërkojnë trajtim IVF. Mbi 20 media kanë shkruar për lajmin në fjalë, në veçanti debati në TV Dukagjini thekson narrativat e lartpërmendura. Incesti, martesat brenda familjeve dhe përzjerja e nacionaliteteve nga donor të huaj janë disa nga argumentet që kanë ngjallur reagime te publiku duke nxitur komente me gjuhë të urrejtjes.

Një nga kundërshtimet kryesore të ngritura kundër ligjit të ri të IVF-së është frika se mund të ketë raste të incestit ose martesave midis vëllezërve dhe motrave. Deputetë argumentojnë se anonimiteti i informacionit të donatorëve mund të çojë në marrëdhënie të panjohura me të afërm, duke paraqitur dilema etike dhe ligjore për individët dhe familjet e përfshira. Një tjetër pikë mosmarrëveshjeje rreth ligjit të IVF-së ka të bëjë me pasigurinë që rrethon kombësinë e donatorëve që kontribuojnë me material gjenetik për procedurën. Argumentohet se kjo mungesë transparencës mund të krijojë konfuzion dhe kompleksitet ligjor, veçanërisht në lidhje me çështjet e shtetësisë.

Një pasojë veçanërisht shqetësuese e debatit rreth ligjit për IVF në Kosovë është shfaqja e gjuhës së urrejtjes që synon gratë që kërkojnë trajtim IVF. Narrativat e përmendura kanë kontribuar në përhapjen e stereotipave nënçmuese dhe qëndrimeve diskriminuese ndaj këtyre individëve. Për më tepër, ekziston rreziku që një retorikë e tillë mund të përjetësojë keqkuptime dhe keqinformime në lidhje me procedurat e IVF, duke minuar mirëkuptimin publik dhe duke përkeqësuar ndarjet shoqërore, të cilat tregohen më së miri në komente të rrjeteve sociale.

Postimet nga TV Dukagjini në lidhje me projektligjin për IVF ka pasur gjithsej 1982 ndërveprime prej të cilave:

1,168 Pëlqime  
757 Komente  
57 Shpërndarje

Konferenca me temë “Politikat progresive – përgjigje ndaj sfidave të vendeve të Ballkanit Perëndimor” me datë 9 shkurt, në Maqedoninë e Veriut kishte të ftuar edhe Kryeministrit Kurti. Nga Radio Televizioni i Kosovës (RTK) u publikua lajmi me titull “Detaje të planit serb për atentat ndaj Kurtit në Shkup”, duke u bazuar në burime të veta. Pas publikimit në RTK, mediat online kanë publikuar lajmin se ka pasur atentat ndaj kryeministrit të Kosovës. Një mangësi e dukshme në narrativën e komplotit të supozuar të atentatit është mungesa e burimeve të besueshme. Artikulli fillestar dhe riprodhimet e mëvonshme nuk citojnë ndonjë burim të besueshëm për të vërtetuar pretendimet e tyre. Në vend të kësaj, mbështeten në pohime të paqarta dhe tituj të bujshëm për të tërhequr vëmendjen. Mungesa e provave apo dëshmive konkrete nga autoritetet e besueshme vë në dyshim vërtetësinë e të gjithë rrëfimit.

Për më tepër, Qeveria e Maqedonisë së Veriut menjëherë i hodhi poshtë pretendimet, duke deklaruar se nuk ka pasur tentativë për atentat ndaj kryeministrit Kurti gjatë vizitës së tij në Shkup. Ky mohim zyrtar minon besueshmërinë e raporteve të lajmeve dhe thekson rëndësinë e verifikimit të informacionit edhe kur ato publikohen nga transmetues publik, siç është RTK. Pavarësisht rrëzimit të pretendimeve nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut, rreth 25 media i dhanë zë lajmit për atentat, duke vazhduar ciklin e dezinformatave. Duke pasur parasysh mungesën e provave të vërtetuara dhe mohimin zyrtarë, këto raporte klasifikohen si lajme të paverifikuara dhe dezinformata. Përhapja e informatave të tilla jo vetëm që dëmton reputacionin e individëve dhe transmetuesve publik, por gjithashtu minimizon besimin e publikut në media. Për më tepër, përhapja e narrativave të paverifikuara mund të ketë pasoja të gjëra, duke përkeqësuar tensionet midis vendeve fqinje dhe duke intensifikuar mosmarrëveshjet brenda komuniteteve.

**A kishte plan për atentat ndaj Kurtit në Shkup? Flet kryeministri**

**LAJMI:**  
3,883 Pëlqime, 2,596 Komente, 2,039 Shpërndarje

**FACEBOOK:**  
528 Pëlqime, 80 Komente, 14 Shpërndarje

**INSTAGRAM:**  
667 Pëlqime, 66 Komente, 0 Shpërndarje

**YOUTUBE:**  
146 Pëlqime, 16 Komente, 25,918 Shikime

460 artikuj në media,  
5 postime në Facebook,  
9 postime në Instagram,  
5 video në YouTube

Më 26 qershor 2023, është publikuar një audio-regjistrim i pavërtetë 'deepfake' në platformën X, ku prezantohet një bisedë mes Kryeministrit Kurti dhe Ambasadorit Amerikan në Kosovë, Jeffrey M. Hovenier. Audio regjistrimi u fokusua në diskutimet lidhur me arrestimin e serbëve në Kosovë. Një bisedë e tillë nuk ka ndodhur në mes Kryeministrit Kurti dhe Ambasadorit Hovenier. Postimi origjinal tani ka arritur më shumë se 150,000 shikime. Titulli i postimit lexon kështu "Duhet të dëgjohet! KURTI ka regjistruar në një bisedë me të ashtuquajturin ambasadorin amerikan në Prishtinë, Hovenier: "Arrestojmë serbët në veri dhe nuk na intereson nëse janë kriminelë apo përgjegjës për dhunën apo jo, ne do të vazhdojmë t'i arrestojmë ata...".

**Postimi mori 140 shpërndarje dhe 245 pëlqime, shumica e të cilave vijnë nga llogari anonime dhe imituese në X.**

Pëlqime	Shpërndarje
245	140

Portali i lajmeve, Kanal10 ka publikuar një artikull me titull: "Shpërthen Matoshi ndaj Kurtit: I paskrupullt, rrenc, budalla e idiot." Përdorimi i gjuhës ofenduese ndaj Kryeministrit Albin Kurti ka ardhur si rrjedhojë e ngjarjeve që kanë ndodhur në katër komunat në veri të Kosovës dhe masat që i janë vendosur Kosovës nga Bashkimi Evropian.

**Ky artikull ka arritur 1,034 ndërveprime duke përfshirë: 385 pëlqime:**

Pëlqime	Komente	Shpërndarje
385	642	7

Portali i lajmeve, Klan Kosova, ka publikuar deklaratën e Hysni Klinakut, ushtrues i detyrës së kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, me titull: "Klinaku i OVL-UÇK: Më parë e vras Albin Kurtin sesa të iki nga Kosova". Këtë deklaratë Klianku e ka bërë përmes një postimi në rrjetin e tij social Facebook. Gjuha e përdorur nga Klianku është gjuhë kërcënuese dhe nxitëse ndaj kryeministrit Albin Kurti. Kjo deklaratë e drejtuesit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së kontribuon në polarizim të mëtejshëm politik. Në të njëjtin artikull të shpërndarë në faqen zyrtare të Klan Kosovës në Facebook, shihet një reagim nga komentues të ndryshëm me tone të ashpra ofenduese drejtuar z. Klinaku.

**LAJME:**

Pëlqime	Komente	Shpërndarje
4,774	7,229	1,242

**FACEBOOK:**

Pëlqime	Komente	shikime
39	48	1

255 artikuj në medias,  
8 postime në Facebook

Portali Albanian post ka publikuar një artikull me titull: "Njësia Speciale Intervenuese (NjSI, FIT) po shqyrton largimin nga radhët e policisë, pakënaqësi me Qeverinë e Kosovës". Më tutje në përmbajtje të artikullit thuhet se ky lajm bazohet "në burime brenda kësaj njësie", mirëpo nuk ka ndonjë shpjegim më të qartë për vërtetësinë e lajmit. D4D ka hulumtuar për ndonjë komunikatë nga Policia e Kosovës ku mund të verifikohet ky lajm, por një komunikatë e tillë nuk është bërë nga Policia e Kosovës dhe as nga Qeveria e Kosovës. Tre portale kanë raportuar, dy prej të cilave mund ta kenë marrë lajmin nga Albanian Post sepse janë publikuar më vonë në të njëjtën ditë.

**Ky lajm gjithsej ka grumbulluar 753 ndërveprime, prej të cilave janë:**

Pëlqime	Komente	Shpërndarje
554	180	19

Një llogari në TikTok me emrin Kanalstat e Kosovës, ka publikuar një video ku shihet Kryeministri Kurti gjatë një interviste duke folur në gjuhën arabe. Kjo video, e cila u bë virale pasi që pati një shikueshmëri të lartë, është prodhim i inteligjencës artificiale e cila mund të gjenerojë përmbajtje që nuk janë të vërteta. Kjo cilësohet si Deepfake, në rastin e vërtetë Kryeministri Kurti ishte duke dhënë një intervistë për një media të huaj në gjuhën angleze.

**Kjo video ka marrë 5,625 pëlqime, 483 komente, 2183 shpërndarje, dhe është ruajtur si video nga 1574 përdorues të TikTok-ut.**

Pëlqime **5,625**    Komente **483**    Shpërndarje **2183**


Portali Epilogu ka postuar një artikull me titull: “Mediumi gjerman FAZ: Politikat e Kurtit në përputhje me planet serbe për destabilizim të rajonit”. Artikulli nga Epilogu përmend se sot (data 3 janar 2024) është publikuar një artikull nga mediumi gjerman Frankfurt Allgemeine Zeitung (FAZ), megjithatë D4D ka gjetur se lajmi në gjuhën gjermane ishte publikuar në qershor të vitit 2023. Gjuha e përdorur në titullin e postuar “Politikat e Kurtit në përputhje me planet serbe për destabilizim në rajon”, ka elemente të keqinterpretimit të lajmit, pasi që titulli në fjalë mund të interpretohet sikur “politikat e Kurtit janë bërë qëllimshëm në përputhje me planet serbe”. Mirëpo, gazetari gjerman, Michael Martens, shkruan se vendimet e Kurtit po ja bëjnë më të lehtë Vuçiqit destabilizimin në rajon. Për më tepër Epilogu përmend intervistën që gazetari Martens kishte realizuar më herët me Kryeministrin Kurti duke përfshirë edhe faktin se gazetari i është dashur të largojë disa pjesë “të rëndësishme” nga intervista që lë hapësirë për krijim të një skandali. “Ai i kishte hequr Kurtit fjalët më të rëndësishme nga një intervistë në muajin nëntor, ku kryeministri e pranonte që ambasadori amerikan kishte ditur më shumë mbi situatën në veri të vendit, çka e kishte shtyrë që të tërhiqej nga çështja e targave ilegale.”- shkruan Epilogu. Gazetari gjerman në vitin 2022, kur ishte realizuar intervista, ishte sqaruar se të gjitha pjesët e hequra ishin të aprovuara nga ekipi i Kryeministrin Kurti, por nuk e ka konsideruar si të rëndësishme për ta mbajtur në draftin final. Përmes platformës X, ai kishte sqaruar se pjesa e hequr nuk kishte shumë rëndësi për lexuesit gjerman dhe prandaj janë hequr disa pjesë për të qenë intervista më e shkurtër. Lajm i shpërndarë nga mbi 10 medime online kanë grumbulluar rreth 36.000 klikime në faqet e tyre të internetit.

**Mediumi gjerman FAZ: Politikat e Kurtit në përputhje me planet serbe për destabilizim të rajonit**

Lajm i shpërndarë nga mbi 10 medime online kanë grumbulluar rreth 36.000 klikime në faqet e tyre të internetit.

Klikime **36.000**

Vëllimi i artikujve të publikuar në media në ditë:



Dita e dhunës në Kuvendin e Kosovës, gjatë së cilës u sulmua kryeministri Kurti, shënoi ditën më aktive për mediat kosovare. Në këtë ditë u prodhuan 3,826 artikuj lajmesh mbi këtë temë, duke gjeneruar 125,055 angazhime.


**STATISTIKA TË PËRGJITHSHME:**

Artikuj në media	<b>439,197</b>
Ndërveprime ne Facebook	<b>7,876,136</b>
Ndërveprime për artikuj	<b>18</b>
Numri i mediave	<b>116</b>
Postime në mediat sociale	<b>28,996</b>
Ndërveprime	<b>4,092,406</b>
Ndërveprime për postim	<b>141</b>

# Gjuha e urrejtjes dhe mizogjene online

Artikujt e përzgjedhur më poshtë nëpërmjet metodologjisë së përdorur në këtë raport, synojnë të tregojnë për gjuhën e urrejtjes dhe mizogjene të përdorur në mediat online. Raporti tregon për manifestimin e këtyre dukurive në baza gjinore kundër grave në politikë dhe në gjuhën e përdorur nga përdoruesit e rrjeteve sociale.

Videot Deepfake janë shpërndarë gjithashtu në platforma të tjera të mediave sociale si Facebook dhe TikTok. Një video e manipuluar dhe e pavërtetë është shfaqur në TikTok që përshkruan deputeten Mimoza Kusari-Lila, kryetare e grupit parlamentar të LVV-së dhe Slavko Simiç, anëtar i kryesisë së Listës Serbe, duke kënduar së bashku në serbisht. Kjo video, e cila tani ka më shumë se 20,700 shikime, është shpërndarë gjatë një periudhe kur Kuvendi i Kosovës u angazhua në diskutime lidhur me disa incizime mes Kusarit dhe Simiçit, regjistrime të cilat mediat i kishin bërë publike. Videoja është fshirë dhe nuk ekziston më si link.



Portali i lajmeve Gazeta Express ka publikuar një artikull me titull: “Krasniqi: Zyrtarë të lartë të Qeverisë brenda VV-së kanë lënë gra shtatzënë, kanë vjedhur donacione”. Ish-deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Florin Krasniqi, në një emision televiziv, ka thënë se: “zyrtarë të lartë të Qeverisë brenda VV-së kanë bërë gjëra të ulëta morale, lënë gra shtatzënë e kanë vjedhur kerre donacion”. Ish-deputeti përmes kësaj deklarate drejton akuza të rënda për keqpërdorim të detyrës zyrtare duke përdorur edhe gjuhë mizogjene. Akuzat e ish-deputetit të VV-së janë të pabaza pasi që pas verifikimit që ka bërë D4D, brenda vitit 2023, nuk ka pas raportime të tilla, siç pretendon ish-deputeti, Krasniqi.

**Krasniqi: Zyrtarë të lartë të Qeverisë brenda VV-së kanë lënë gra shtatzënë, kanë vjedhur donacione ...**



**Ky artikull ka pasur 292 ndërveprime:**

 Pëlqime	 Komentë	 Shpërndarje
<b>114</b>	<b>162</b>	<b>16</b>

Një tjetër artikull nga Epilogu me titull: “Kimete Berisha: Donika Gërvalla është hajnesha më e shëmtuar, Kurti i duket luan budallicës”. Titulli në fjalë i vendosur në thonjëza nuk përmban informatë por vetëm një mendim të personal që cilësohet si mendim subjektiv. Përsëri, titulli kontribuon në normalizimin e gjuhës mizogjene dhe ofenduese në sferën mediatike, duke zgjedhur mbiemra ofendues, në të njëjtën kohë nxitë qytetarët për të sulmuar gratë online.

**Kimete Berisha: Donika Gërvalla është hajnesha më e shëmtuar, Kurti i duket luan budallicës**




**Postimi në Facebook ka grumbulluar 304 ndërveprime, prej të cilave janë:**




 Pëlqime	 Komentë	 Shpërndarje
<b>170</b>	<b>120</b>	<b>5</b>

Gazeta Demos ka publikuar një video ne Instagram me titull: “Gjyqtari ‘ia rrah’ tavolinën avokates së Hajdar Beqës”. Video në fjalë përmban pamje nga seanca e gjyqimit të deputetëve të cilët u përleshën fizikisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në videon e postuar shihet avokatja Besiana Ismajli duke argumentuar derisa ndërpritet nga gjyqtari pasi që nuk ja kishte dhënë fjalën avokates. Raportimi nga mediumi Demos, shihet të ketë përdorur një gjuhë me elemente mizogjene e cila nuk kontribuon në informimin e qytetarëve për rastin gjyqësor në fjalë, por fokusohet te një moment teknik që nuk ka lidhje me ndonjë zhvillim të mëtutjeshme të rastit. Shprehja “ia rrah tavolinën” edhe nëse vendoset në thonjëza nuk arsyeton përzgjedhjen e fjalëve ndaj avokates znj. Ismajli. Për më tepër znj. Ismajli nuk është avokatja z. Beqa, por e z. Lushtaku, andaj edhe përshkrimi i keqinformon qytetarët. Si pasojë e shprehjes së përdorur në titullin e postimit është nxitur një gjuhë fyese jo vetëm ndaj z. Ismajli po edhe ndaj gjyqtarit Eroll Gashi.


**Video e postuar në Instagram ka grumbulluar:**



**Video e postuar në Instagram ka grumbulluar:**

 Pëlqime	 Komentë	 Shpërndarje
<b>219</b>	<b>23</b>	<b>84</b>

Vëllimi i artikujve të publikuar në media në ditë:



Në analizën e gjuhës së urrejtjes në Kosovë bazuar në fjalët kyçe të ofruara, kulmi më i lartë i artikujve të lajmeve përkoi me periudhën e sulmit në Banjskë, kryesisht për shkak të fjalës "Terrorist" të përdorur në mediat kosovare.

Mirëpo, në totalin e përmendjeve ra fjala "vjedhje" me 8,313 përmendje, e ndjekur nga "terroristë" me 5,830 përmendje, "shpifje" me 3,048 përmendje, "provokon" me 1,426 përmendje, dhe "homoseksual" me 1,110 përmendje.

STATISTIKA TË PËRGJITHSHME:	
Artikuj në media	26,509
Ndërveprime ne Facebook	465,443
Ndërveprime për artikuj	18
Numri i mediave	106
Postime në mediat sociale	1,585
Ndërveprime	253,778
Ndërveprime për postim	118

# Ndikimi i huaj jodemokratik

Artikujt e përzgjedhur më poshtë nëpërmjet metodologjisë së përdorur në këtë raport, synojnë të tregojnë për ndikimin e jashtëm. Në këtë kategori veçohet efekti që ka shkakuar një gabim në përkthim i fjalimit të Presidentit Macron, duke sjellë një perceptim të gabuar se Franca po pezullon vizat për Kosovën, si përgjigje të tensioneve në veri. Ky gabim shkaktoj debate të ashpra në media kundër qeverisë së Kosovës që fajësohej për këtë "dështim" në liberalizim të vizave, si dhe rritje të gjuhës së urrejtjes ndaj Francës dhe Presidentit Macron.

Gjatë një fjalimi të Presidenti Francez, Emanuel Macron, në një konferencë për shtyp në Tiranë ku po qëndronte në vizitë zyrtare, ka folur për tensionet në veri dhe liberalizimin e vizave për Kosovën. Përkthimi në gjuhën shqipe i fjalimit të Presidenti Macron nuk ishte i saktë, pasi mediat kanë raportuar gjerësisht mbi keqinterpretimin e përkthimit të fjalimit të Presidentit Macron. Përkthimi i fjalimit ishte si në vijim: "E them me qartësi, ju kemi besuar për vizat, çështja është pezulluar nga ana e Francës sepse ka të bëjë me respekt për fjalën e dhënë dhe fjala nuk po mbahet. Pres që palët të angazhohen që të ecin përpara dhe është kushti i paqes në të gjithë zonën". Ky është përkthimi zyrtar i publikuar në faqen zyrtare të Kryeministrit të Shqipërisë. Duke iu referuar ndodhive të fundit në veri të Kosovës, Macron ka shprehur se fjala e dhënë nga dy shtetet për stabilizimin e situatës në veri nuk po mbahet, por nuk ka thënë si pasojë do të pezullohen vizat.

Si rrjedhojë, shumë media në Kosovë dhe Shqipëri, duke përfshirë edhe rrjetet sociale dhe portalet online, kanë shpërndarë lajmin se Franca pezullon vizat për Kosovën. Disa nga mediat e kanë korrigjuar lajmin e disa të tjera kanë vazhduar ta mbajnë lajmin e keqinterpretuar. Ndikimi i një informate me përmbajtje të çrregullimit të informacionit vërehet në këtë rast ku edhe figura publike në Kosovë reagojnë ashpër kundrejt Qeverisë së Kosovës për "pezullimin e vizave".

**Macron: Franca ka pezulluar liberalizimin e vizave për Kosovën**



**40 media**  
**4239 ndërveprime**


Pëlqime **2,816**
 Komente **1,279**
 Shpërndarje **244**

Portali i lajmeve "AlfaPlam", ka publikuar artikullin me titull: "Idetë e Kurtit janë katastrofale dhe gjenocidale". Këto pretendime kanë ardhur nga Milan Vuçević udhëheqës i Partia Progresive Serbe. E gjithë kjo lidhet me deklaratën e deputetes në parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar, Alicia Kearns, që ka paraqitur dëshmi mbi përfshirjen e kishës ortodokse serbe në trafikim të armëve në Kosovë. Në këtë deklaratë po ashtu ngritën hipoteza se një shqiptar në Shtërpcë ka dëshmi se si do të arrestohen serbët, dhe deklaroi se në bazë të këtyre fjalëve mbi 20 familje serbe janë larguar nga Kosova. E gjithë këto i atribuohen Kryeministri të Kosovës, Albin Kurti dhe thotë se prapa tyre qëndron po i njëjti me këto ide të cilat janë 'katastrofale' dhe 'gjenocidale'.

**Ky lajm ka 1,762 ndërveprime, prej tyre:**

- Pëlqime: 1,607
- Komente: 19
- Shpërndarje: 136

**Vëllimi i artikujve të publikuar në media në ditë:**



Kanë qenë të shumta kulmet e situatës në Kosovë që kanë ngjallur reagime nga bashkësia ndërkombëtare. Filloi me deklaratën e deputetes britanik Kearns, që nxiti rreth 1,500 artikuj lajmesh të botuara atë ditë. Pas kësaj, gjatë javës së situatës në Banjskë të Kosovës, vazhdimisht publikoheshin mbi 1,400 lajme në ditë. Për më tepër, në ditën e përvjetorit të fillimit të bombardimeve të NATO-s, u botuan mbi 1,200 artikuj lajmesh.

Për sa i përket ndërveprimeve, ngjarja e Banjskës (dita e sulmit dhe 10 ditët në vijim) përbënte 10% të numrit të përgjithshëm të ndërveprimeve për të gjithë periudhën e monitorimit (335 ditë).

STATISTIKA TË PËRGJITHSHME:	
Artikuj në media	188,717
Ndërveprime ne Facebook	3,490,307
Ndërveprime për artikuj	18
Numri i mediave	114
Postime në mediat sociale	7,623
Ndërveprime	1,653,803
Ndërveprime për postim	217

